

Integrimi në BE, partitë politike, dhe iniciativat regionale në Ballkanin Perëndimor

Hyrje

Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse (CIG) ka mbajtur një diskutim në formatin e tryezës së rrumbullakët më 19 dhe 20 tetor, 2019 në Shkup, Maqedoni e Veriut, me disa zyrtarë të partive politike nga shtetet e Ballkanit Perëndimor për të adresuar sfidat e brendshme dhe të jashtme të rajonit përgjatë rrugës drejt konsolidimit demokratik dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Qëllimi i kësaj iniciative është të rrisë bashkëpunimin rajonal dhe koordinimin në reformat e brendshme dhe ekonomike, si dhe të ndihmojë në zgjidhjen e problemeve bilaterale. Pjesëmarrësit konstatuan që shtetet e tyre duhet t'i zbatojnë reformat së pari për përmirësimin e jetës së qytetarëve, dhe vetëm pastaj për të mundësuar anëtarësimin në BE. Anëtarësimi në BE nuk duhet të jetë qëllim në vete, por më shumë si rezultat i qeverisjes së mirë në rajon.

Tryeza e diskutimit është pjesë e një iniciative të CIG për bashkëpunim rajonal dhe zhvillim demokratik, mbështetur dhe zbatuar në bashkëpunim me Zyrën Federale të Gjermanisë për Punë të Jashtme.

Shtetet në rajon janë të varura nga njëra tjetra në aspektet ekonomike dhe politike. Siç është ilustruar së fundmi nga vendimi i BE-së për të tejzgjatur hapjen e negociatave me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë, konfliktet e brendshme politike në Shqipëri janë poashtu probleme të Maqedonisë së Veriut kur bie fjala për integrimin në BE. Këto shtete kanë sfida të ndryshme, por aspiratat i kanë të përbashkëta. Shqipëria ballafaqohet me sfida të mëdha të brendshme, kurse Maqedonia e Veriut është ballafaquar edhe me probleme të brendshme edhe të jashtme, por ia ka dalë t'i adresojë të dyjat me sukses, por, sipas disa prej pjesëmarrësve, ky shtet e humbi “trenin e shpejtë për integrimin në BE.” Mali i Zi ka marrëdhënie të mira me shtetet fqinje, por përballet me një varg sfidash në reformimin e sistemit demokratik. Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, dhe Kosova janë akoma të ndjekura nga historia e konflikteve të pazgjidhura të brendshme dhe të jashtme, duke ua zënë rrugën hapësirës për reforma. Çështja e konfliktit mbi statusin mes Kosovës dhe Serbisë ndikon në tërë rajonin. Prandaj, zëri i rajonit në konfliktet e pazgjidhura është me rëndësi.

Raporti bazohet në diskutimet e tryezës së rrumbullakët të mbajtura nën Rregullën e Shtëpisë Chatham. Pjesëmarrësit morën pjesë në diskutime në çilesi personale. Ne jemi munduar të jemi të saktë dhe të ekuilibruar në përmbledhjen e diskutimeve duke kërkuar mirëkuptimin e pjesëmarrësve, diskutimet e të cilëve mund të mos jenë përfshirë plotësisht në këtë raport të

shkurtër. Raporti nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e CIG dhe Zyrës Federale të Gjermanisë për Punë të Jashtme.

Sfida të njëjta, të ardhme të përbashkët

Vendet e Ballkanit Perëndimor janë pak a shumë në të njëjtën varkë sa i përket marrëdhënieve në procesin e anëtarësimit në BE. Bashkëpunimi rajonal është thelbësor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve politike dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik dhe shoqëror. Vendet e rajonit kanë aspirata dhe qëllime të përbashkëta. Ato duhet të dakordohen mes vete që të bashkëpunojnë më shumë përgjatë rrugëtimit në arritjen e këtyre qëllimeve të përbashkëta. Vendet e rajonit kanë nevojë për më shumë vetëbesim për bashkëpunim me njëri-tjetrin dhe me BE-në. Ka shumë arsye të përbashkëta mbi të cilat mund të bazohet kjo marrëdhënie bashkëpunuese. Shumë prej pjesëmarrësve thanë që rajoni do të ishte më i fortë dhe më i zëshëm nëse do të fliste njëzëshëm jo vetëm për integrimin në BE, por edhe për çështje siç janë siç janë ikja e profesionistëve, tregtia dhe arsimi.

Zbatimi i reformave së pari për zhvillimin e brendshëm. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të punojnë më shumë me forcat e tyre, e të llogarisin më pak në BE për përbushjen e kushteve për anëtarësim në BE. Ata duhet të bëjnë reformat për qytetarët e tyre, dhe jo sepse BE i kërkon ato. Reformat janë të nevojshme me ose pa anëtarësimin në BE. Vendet e Ballkanit Perëndimor janë gjithashtu më pak të varura nga mbështetja e BE-së nga sa mendojnë shumica, duke pasur kapacitete të mjaftueshme të brendshme për të përshpejtuar procesin e reformave. Tregimi se “ne po bëjmë reformat për hir të BE-së” duhet të ndryshojë në “ne po bëjmë reformat për të mirën tonë.”

Rritja e aftësive institucionale dhe rimëkëmbjes. Pengesat e përkohshme siç është vendimi i BE-së për tejzgjatjen e fillimit të negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut nuk duhet të dekurajojnë vendet e Ballkanit Perëndimor që të vazhdojnë me reformat. Vendimi i BE-së mund të dëmtojë procesin deri në një masë, por vendet duhet të ndërtojnë pajtueshmëri të brendshme mbi një vizion afatgjatë, si dhe të ecin përpara me zbatimin. Pengesa të tilla duhet të shërbejnë për të forcuar rimëkëmbjen e rajonit. Një nga pjesëmarrësit e tryezës tha se për ata që thonë se Maqedonia e Veriut “hoqi dorë nga gjithçka dhe nuk mori asgjë,” përgjigja është se Maqedonia Veriore e bëri emrin kompromis për të çuar përpara reformat dhe për të krijuar marrëdhënie të mira me fqinjët e saj, jo si një favor për BE-në. “Ne e bëmë kompromisin për veten tonë.” Vendet e Ballkanit duhet të bindin BE-në se ata po bëjnë reformat për të mirën e vetvetes. Mirëpo, disa pjesëmarrës thanë që disa kërkesa të BE-së, siç është “kërkimi nga Maqedonia të ndryshojë emrin e saj” shkelin vlerat e BE-së. “Shtytja e vendeve për të ndryshuar emrat e tyre, dhe kështu një pjesë të identitetit të tyre, nuk është një parim evropian.” Disa sugjeruan që rajoni do të merrte lajme më zhgënjyese gjatë procesit, por është diçka që duhet të mësojnë ta menaxhojnë.

Rajoni të bëhet më atraktiv për BE-në. Shtetet e Ballkanit duhet ta sjellin BE-në në atë pozitë që vetë BE-ja t’i dëshirojë këto vende, e jo t’ua ketë frikën. Këto shtete duhet të përpiqen të bëhen partnerë serioz me BE-në, jo vetëm të kërkojnë ndihmë dhe ta perceptojnë veten si të varur nga BE. Vendet e Ballkanit duhet të zgjidhin vetë disa nga mosmarrëveshjet, jo gjithmonë të presin ndërmjetësimin e BE-së. Me fjalë të tjera, qeveritë dhe udhëheqësit në rajon duhet të lënë

mënjë politikë e imëta dhe t'i adresojnë mosmarrëveshjet në një mënyrë të mirëfilltë që të arrijnë në një zgjidhje. Praktika e deritanishme ka treguar që udhëheqësit përfshihen në negociata për zgjidhjen e problemeve pikërisht për të vonuar ofrimin e zgjidhjeve dhe për t'i japur vetes më shumë kohë për të qëndruar pushtet. Rajoni ka nevojë për mënyra institucionale për të zgjidhur problemet, jo ujdi midis udhëheqësve. BE duhet të mbështesë institucionet dhe demokracinë në partitë politike të Ballkanit Perëndimor, jo individët.

Partitë politike dhe reformat

Partitë politike globalisht janë duke u bërë komponenti më së paku i respektuar i sistemit demokratik. Ato kanë evoluar gjatë dekadave nga të qenit ideologjikisht të dallueshme, tek të qenit parti të përgjithshme “për të kapur të gjitha,” duke favorizuar tregun e lirë dhe qeveritë e vogla. Lidhjet partizane po bienin falë qytetarëve të rinj që janë të edukuar siç duhet, dhe të cilët kanë nivele më të ulëta të besnikërisë partiake, edhe pse duket se kanë interes dhe angazhim më të lartë politik. Brezat e rinj janë të shqetësuar më shumë për cilësinë e çështjeve të jetës sesa për shqetësimet kombëtare. Vlerat e demokracisë nuk janë të rrënjësura thellë në demokracitë e reja të Ballkanit. Shumica e pjesëmarrësve në tryezë thanë që partitë politike nuk janë institucionalisht të forta dhe të qëndrueshme, dhe shpesh kontrollohen nga individë ose grup individësh. Shumica e themeluesve të partive në rajon janë ende duke udhëhequr partitë e tyre. Disa parti i ngjajnë asaj që njihet si ‘parti karteli’ të drejtuara nga elita të vetë-interesuara për kërkim të pushtetit. Disa pjesëmarrës thanë se politikanët gjithashtu trashëgjuan qëndrime antidemokratike nga sistemet e mëparshme komuniste, në të cilat dallimet në opinione nuk u toleruan. Shumë prej pjesëmarrësve sugjeruan që partitë e forta institucionale dhe aftësitë e tyre të performancës janë një kusht kryesor për konsolidimin e demokracisë.

Adresimi i deficitit demokratik në rajon. Rajoni duhet të punojë më shumë për demokratizimin dhe zhvillimin e politikave. Partitë shihen si instrumente biznesi për tu pasuruar përmes qasjes së privilegjuar në burimet kombëtare dhe për të shijuar detyrat e zyrës. Disa pjesëmarrës thanë që shumë parti kanë udhëheqje të partive autoritare dhe se ato duhet të marrin pushtetin nga udhëheqjet e tilla dhe të decentralizojnë vendimmarrjen. BE-ja mund të ndihmojë në zhvillimin e partive. Korrupsioni është fajtori kryesor në rrugën drejt zhvillimit demokratik. “Qeveritë ndryshojnë por korrupsioni mbetet.” Politika në rajon është bërë një sinonim i korrupsionit. Politikanët në ditët e sotme janë të lidhur me gënjeshtër, mashtrim dhe vjedhje, dhe ka shumë të vërteta në një perceptim të tillë. Politikanët që gënjejnë dhe vjedhin duke mos u ndëshkuar po bëhen një standard i pranuar nga shoqëria. Partitë duhet urgjentisht të ndërtojnë besimin e publikut dhe të ndryshojnë kulturën e mosndëshkimit.

Më shumë politika publike, më pak politikë. Partitë politike duhet të përqëndrohen më shumë në performanca dhe reforma, e më pak në fitimin e zgjedhjeve. Disa pjesëmarrës thanë që përfitimet financiare po i shtyejnë agjendat e tyre më shumë sesa interesi publik. Partitë duhet të angazhohen më shumë me publikun, të dëgjojnë shqetësimet e tyre dhe t'i përfshijnë ato në axhendat e tyre të politikave. Partitë gjithashtu duhet të ndryshojnë kulturën e marrëveshjeve midis udhëheqësve dhe ta shndërrojnë atë në marrëveshje bazuar në interesin publik. Rritja e presionit publik në këtë drejtim është gjithashtu e rëndësishme.

Përmirësimi i komunikimit midis partive dhe votuesve. Partitë zakonisht komunikojnë me votuesit e tyre gjatë fushatave zgjedhore. Dhe fushatat u shërbejnë udhëheqësve më shumë për të kërkuar vota sesa për të dëgjuar preferencat dhe shqetësimet e votuesve. Studimet tregojnë se mosbesimi në institucionet demokratike në rajon po rritet dhe gjithnjë e më shumë njerëz po kërkojnë një jetë më të mirë jashtë vendit.

Partitë qeverisëse dhe opozitare duhet të ndajnë përgjegjësi dhe merita. Marrëdhëniet midis partive qeverisëse dhe opozitare në rajon janë të tensionuara. Ato rrallë bashkëpunojnë, edhe nëse është fjala për çështje me interes kombëtar. Këto palë duhet të ndajnë si përgjegjësitë, ashtu edhe meritat për dështimet dhe sukseset e vendeve të tyre. Shumë pjesëmarrës thanë se “loja e fajit po dëmton reputacionin e vendeve të tyre jashtë vendit dhe besueshmërinë e partive të tyre në shtëpi.” Partitë duhet të vendosin bashkëpunim brenda sistemit dhe jo në ujdi dhe marrëveshje *ad hoc* midis liderëve. Opozita duhet të përfshihet në hartimin e legjislacionit, jo vetëm në votimin e tij. Partitë qeverisëse duhet t’i marrin me seriozitet propozimet e opozitës dhe të punojnë për blerjen e tyre për çështje kyçe. Interesi kombëtar duhet të përcaktohet në një mënyrë më të gjerë. Konkurrenca partiake gjatë zgjedhjeve dhe bashkëpunimi i partive në zbatimin e politikave gjatë qeverisjes duhet të bazohet në vlera dhe parime demokratike, jo në tekat e udhëheqësve politikë individualë. Disa thanë që shoqëritë e Ballkanit nuk janë të polarizuara për çështjet kombëtare, se polarizimi është vetëm ndërmjet udhëheqësve individualë. Diskutime të rregullta përmes tryezave të rrumbullakëta mes drejtuesve të partive kryesore parlamentare në nivele kombëtare duhet të organizohen më shpesh.

Reformat politike janë të nevojshme. Shumë vende të rajonit duhet të konsiderojnë një reformë serioze të sistemeve të tyre zgjedhore. Poashtu, duhet të ndiqen reforma në rregullimin e financimit të partive politike, si dhe të bëhet përmirësimi i këtij sistemi. Punët e deputetëve duhet të profesionalizohen.

Prioritetet rajonale dhe iniciativat

Pjesëmarrësit menduan nëse vendet e Ballkanit mund të bëjnë diçka së bashku për të çuar përpara qëllimin e tyre të përbashkët, për ta përafuar rajonin me standardet politike dhe ekonomike të BE-së. Pavarësisht nga dallimet e tyre se si këto vende perceptojnë një numër mosmarrëveshjesh, ato mund të punojnë në izolimin e dallimeve dhe avancimin e pikave të marrëveshjes. BE-ja konsiderohet si një mjet për stabilitetin dhe zhvillimin e Ballkanit dhe alternativa e vetme për rajonin. “Ne nuk kemi asgjë më të mirë.” Por nëse BE-ja ngadalëson procesin e integritit edhe për shkak të çështjeve të saj të brendshme, rajoni nuk ka pse të ulet dhe të presë: ai mund të ndërmarrë nisma që krijojnë stabilitet dhe zhvillim dhe kështu të përshpejtojnë procesin e integritit. Përderisa BE-ja ka nguruar në hapa zyrtarë drejt integritit, gjithmonë ka qenë e gatshme të mbështesë nismat rajonale. Procesi i Berlinit është një shembull i mirë i angazhimit të BE-së për rajonin. Disa pjesëmarrës sugjerojnë gjithashtu të shmangin përfshirjen në mosmarrëveshje të mëdha. “Le të mos jemi në ushtarë në tabelat e shahut të të tjerëve, por përkundrazi, le të përqendrohemi në mbrojtjen e interesave të votuesve tanë.” Vendet e Ballkanit Perëndimor janë shumë të vogla për të zgjidhur çështjet globale. Ato duhet të zgjidhin problemet e shumta në vend, të anëtarësohen në BE dhe të punojnë për të pasur ndikim në botë si anëtare të BE-së.

Pjesëmarrësit artikulojnë një numër përparësish dhe iniciativash të përafërta që mund të adresohen bashkarisht. Shumë prej tyre thanë që mbështetja politike, ekonomike dhe financiare e BE-së është thelbësore që iniciativat e vendit të jenë të suksesshme. Mbështetja e BE-së është gjithashtu e rëndësishme për të menaxhuar tejkalimin e mosbesimit që vendet e rajonit kanë ndaj njëri-tjetrit.

Kufinj të bëhen të parëndësishëm. Rajoni duhet të bashkëpunojë në liberalizimin e lëvizjes së mallrave, njerëzve dhe kapitalit për të rritur konkurrencën dhe produktivitetin dhe rrjedhimisht të përmirësojë gjendjen ekonomike. Të gjitha vendet e Ballkanit duhet të jenë pjesë e një nisme të tillë. Nga një marrëveshje e tregtisë së lirë dhe të drejtë me të cilën hiqen pengesat politike dhe administrative do të përfitonin të gjithë. Një numër i pjesëmarrësve patën disa rezerva për një projekt të tillë që tani zbatohet kryesisht nga Beogradi, Tirana dhe Shkupi. Prishtina dhe Podgorica duket se nuk kanë dëshirë të bashkohen, veçanërisht për shkak se iniciativa ka pak detaje, megjithëse në parim të gjithë e mbështetën një ide të tillë. Disa thanë se ideja është e mirë, por nuk ishin të sigurt nëse udhëheqësit janë mjaftueshëm serioz në lidhje me të apo thjesht pretendojnë të bëjnë diçka. “Veprimet e tyre nuk përputhen me fjalët e tyre.” Ndoshta jo çdo vend do të përfitonte në mënyrë të barabartë, por këto janë sfida që duhet të trajtohen në diskutime, në mënyrë që marrëveshja të jetë jo vetëm e lirë, por edhe e drejtë, në mënyrë që çdo vend të përfitojë në mënyrë të barabartë. Disa vende do të përfitonin më shumë se të tjerët në një afat të shkurtër. Vendet me kapacitete prodhuese më të mira përfitojnë më shumë në fillim, por pabarazitë e tilla mund të korrigjohen përmes një numri masash të përkohshme, siç janë kuotat ose subvencionet. Asnjë tregti e lirë nuk është plotësisht e lirë. BE në parim mbështet iniciativën të tilla por do të donte të dinte më shumë rreth kësaj nisme. Në parim, është në përputhje me vlerat e BE-së. Parimi thelbësor i BE-së është t’i bëjë kufijtë të parëndësishëm. Por procesi duhet të përfshijë të gjitha vendet e Ballkanit dhe duhet të punojë së bashku me procesin e Berlinit. Barazia dhe solidariteti janë thelbësore për zhvillimin e një tregu rajonal të stilit të BE-së. Njëri nga pjesëmarrësit raportoi se drejtuesit e kamionëve kaluan në total 26 milion orë duke pritur në vendkalimet kufitare në Ballkanin Perëndimor, një rajon me rreth 20 milion njerëz.

Dialogu midis Serbisë dhe Kosovës duhet të vazhdojë. Mosmarrëveshja prek të ardhmen e Kosovës dhe të Serbisë, por gjithashtu, në mënyrë indirekte dëmton tërë rajonin. Dialogu duhet të rifillojë sa më shpejt që të jetë e mundur. Vendet e rajonit mund t’i ndihmojnë këto dy shtete përmes ndërmjetësimit dhe përpjekjeve të lehtësimit. Komuniteti ndërkombëtar duhet të vazhdojë të jetë ndërmjetësuesi kryesor i procesit.

Përshpejtimi i reformës në sundimin e ligjit dhe qeverisje. Ka pasur pajtueshmëri që rajoni po vuan nga deficitet demokratik. Sundimi i ligjit jo i duhur në rajon përmendet shpesh si pengesa kryesore për zhvillimin ekonomik të rajonit dhe integrimin në BE. Partitë politike duhet të angazhohen më shumë në propozimin e ligjeve dhe ndryshimeve dhe të llobojnë me institucionet e tyre qeverisëse për të përshpejtuar procesin e zbatimit. Shumë pjesëmarrës thanë se ekziston një zbrastëritje e madhe midis miratimit dhe zbatimit të reformave. Vendet e Ballkanit mund të bashkëpunojnë për të ndihmuar njëri-tjetrin të zbatojnë Kapitullin 23 mbi sundimin e ligjit. BE-ja gjithashtu mund të ndihmojë rajonin në krijimin e mekanizmave dhe praktikave për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar.

Adresimi i çështjes së ikjes së njerëzve me profesione të rëndësishme dhe emigrimit. Ballkani po humbet popullsinë e tij më shpejt se çdo rajon tjetër në Evropë. Emigrimi i profesionistëve, siç janë doktorët dhe inxhinierët, do të ketë pasoja të dëmshme afatgjata për zhvillimin ekonomik të rajonit. Rajoni duhet të bashkëpunojë në krijimin e mundësive për popullsinë e tyre në vend. Brenda, vendet duhet të reformojnë sistemet e tyre të arsimit për t'i bërë ato më të përshtatura me tregjet e punës.

Përmirësimi i bashkëpunimit në fushën e sigurisë. Vendet e Ballkanit duhet të krijojnë bashkëpunim rajonal midis policisë dhe institucioneve të tyre të inteligjencës që synojnë të luftojnë krimin e organizuar ndërkufitar dhe të trajtojnë çështjet e sigurisë. Bashkëpunimi për sigurinë gjithashtu ndihmon në ndërtimin e besimit midis vendeve. Partitë politike mund të ndihmojnë në reformimin e legjislacionit të tyre ekzistues për t'i sjellë ato në përputhje me kërkesat e BE-së.

Identifikimi i projekteve të përbashkëta rajonale. Vendet duhet të identifikojnë projekte të përbashkëta që lidhin rajonin dhe mbështesin zhvillimin ekonomik. Projekte të tilla mund të financohen bashkarisht nga vendet e rajonit. Marrëveshja për roaming telefonike filloi si ide në Samitin Digjital të Shkupit. Do të ketë një samit tjetër dixhital në Tiranë në prill të vitit 2021 dhe mbase vendet mund të arrijnë një marrëveshje atje për eliminimin e tarifave të roaming. Rajoni ka nënshkruar tashmë një marrëveshje për të ulur tarifat e roaming.

Ndarja e përvojave mes vete dhe mësimet e marra mbi procesin e integrimit në BE. Vendet e Ballkanit janë në faza të ndryshme të integrimit në BE dhe ato mund të ndajnë sfidat dhe mësimet e tyre të mësuara me njëri-tjetrin. Vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të ulen dhe të diskutojnë se si ata vetë janë përgjegjës për krijimin e situatës aktuale fatkeqë lidhur me procesin e zgjerimit të BE-së.

Përcaktimi i axhendës së reformës rajonale dhe synimeve kombëtare. Vendet duhet të bëjnë çështje praktike - arsim, kujdes shëndetësor dhe punësim - përparësi kombëtare. Votuesit janë përqendruar gjithnjë e më shumë në cilësinë e jetës sesa në çështjet abstrakte, siç është ndërtimi i ushtrive.

Pjesëmarrësit

Renditja sipas alfabetit në gjuhën angleze

- Arban Abrashi**, Anëtar, Kryesia, Lidhja Demokratike e Kosovës; Deputet, Parlamenti i Kosovës
- Marko Djuric**, Nënkryetar, Partia Progressive Serbe; Drejtor, Zyra për Kosovën dhe Metohinë, Qeveria e Serbisë
- Shpetim Gashi**, Nënkryetar, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse
- Blerta Deliu Kodra**, Anëtar, Bordi Ekzekutiv, Partia Demokratike e Kosovës; Deputete, Parlamenti i Kosovës
- Aleksandra Jerkov**, Nënkryetar, Partia Demokratike; Deputete, Parlamenti i Serbisë
- Belind Kellici**, Kryetar, Forumi Rinor dhe Anëtar, Kryesia, Partia Demokratike e Shqipërisë
- Glauk Konjufca**, Anëtar, Kryesia, Lëvizja Vetëvendosje; Shef i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Parlamenti i Kosovës
- Jeta Loshaj**, Përfaqësuese në Kosovë, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse
- Damjan Manchevski**, Anëtar, Bordi Qendror, Unioni Social-Demokratik i Maqedonisë së Veriut; Ministër i Shoqërisë së Informacionit dhe Administrimit të Maqedonisë së Veriut
- Damir Masic**, Anëtar, Kryesi, Partia Socialdemokrate; Deputet, Parlamenti i Federatës së Bosnjës dhe Hercegovinës
- Srdjan Mazalica**, Anëtar, Bordi Kryesor, Lidhja e Social-Demokratëve të Pavarur; Deputet, Parlamenti i Republikës Serbe
- Timco Mucunski**, Sekretar Ndërkombëtar, Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonase - Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar të Maqedonisë
- Milos Nikolic**, Anëtar, Bordi Kryesor, Partia Demokratike e Socialistëve; Deputet, Parlamenti i Malit të Zi
- Haris Plakalo**, Anëtar, Partia e Veprimit Demokratik; Sekretar i Përgjithshëm, Lëvizja Evropiane e Bosnjës dhe Hercegovinës
- Burim Ramadani**, Sekretar i Përgjithshëm, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës; Ushtrues detyre i Ministrit të Mbrojtjes së Kosovës
- Alex Roinishvili Grigorev**, President, Këshilli për Qeverisje Gjithëpërfshirëse
- Branko Ruzic**, Nënkryetar, Partia Socialiste e Serbisë; Ministër i Administratës Publike dhe Vetëqeverisjes Lokale të Serbisë
- Roland Salvisberg**, Udhëheqës, Politika e Paqes për Evropë dhe Azi, Departamenti Federal i Zvicrës për Punë të Jashtme
- Sabine Stoehr**, Udhëheqëse, Divizioni i Ballkanit Perëndimor, Zyra Federale e Jashtme e Gjermanisë
- Teuta Vodo**, Sekretare Ndërkombëtare, Partia Socialiste e Shqipërisë
- Ivan Vujovic**, Sekretar i Përgjithshëm, Partia Socialdemokrate e Malit të Zi